



Republika e Kosovës
Komuna e Vitisë



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

VITI/ VITINA

**Emri i Kontratës: Hartimi i planit komunal të veprimit për
Efiçencë të Energjisë**

Numri i Kontratës: VI 657– 15 – 065 – 236

Komuna: Viti

**PLANI KOMUNAL PËR EFIÇENCË TË ENERGJISË
2016 – 2020**

Operatori Ekonomik: Elektrobibi

15 dhjetor, 2015

LISTA E SHKURTËSAVE

| | |
|--------|--|
| KE | Komisioni Evropian |
| EE | Efiçienca e Energjisë |
| DEE | Direktiva e Efiçiences se Energjisë(2012/27/EU) |
| TKE | Traktati I Komunitetit të Energjisë |
| SKE | Sekretariati I Komunitetit të Energjisë |
| DPEN | Direktiva mbi performancën e Energjisë në Ndërtesa (92010/31/EU) |
| ZrRE | Zyra e Rregullatorit të Energjisë |
| SE | Sekretariati I Energjisë |
| DSH | Direktiva mbi shërbimet e Energjisë (2006/32/EC) |
| UE | Unioni Evropian |
| ZBE | Zyra e Bashkimit Evropian ne Kosove |
| GIZ IS | GIZ International Services |
| QeK | Qeveria e Kosovës |
| KEDS | Kompania Kosovare për furnizim dhe distribuim me Energji elektrike |
| AKEE | Agjencioni i Kosovës për Efiçience të Energjisë |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| KOSTT | Operatori I Sistemit, Transmisionit dhe Shpërndarjes |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| PKEE | Plani i Kosovës për Efiçiences të Energjisë |
| MF | Ministria e Financave |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| PVKEE | Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçiençë të Energjisë |
| PKBRE | Plani Kombëtar për Burimet e Ripërtërishme |
| ARZH | Agjencitë Regjionale për Zhvillim |
| BRE | Burimet e Ripërtërishme të Energjisë |
| NVM | Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme |

PËRMBAJTJA

- 1. HYRJE**
- 2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**
 - 2.1. OBJEKTIVAT E PKEE**
 - 2.1.1. KORNIZA LIGJORE**
- 3. PËRSHKRIMI I KOMUNËS SË VITISË**
 - 3.1 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME**
 - 3.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMUNËS SË VITISË**
 - 3.3. VIZIONI DHE QËLLIMI**
 - 3.4. MENAXHIMI I ENERGJISË NË KOMUNË**
 - 4.5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI**
- 4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË NË KOMUNËN E VITISË**
 - 4.1. FURNIZIM ME ENERGJI I KOMUNËS SË VITISË**
 - 4.1.1. SIGURIA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE**
 - 4.2. KONSUMUESIT E FUNDËM TË ENERGJISË**
 - 4.3. STOKU I NDËRTESAVE NË MENAXHIM TË KOMUNËS SË VITISË**
 - 4.3.1. REKOMANDIM I PËRGJITHSHEM NË LIDHJE ME STOKUN E NDËRTËSAVE PUBLIKE**
- 5. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË**
 - 5.1. SHPËRNDARJA E ENERGJISË SIPAS KONSUMIT**
 - 5.2. NDËRTESAT E SEKTORIT TË ADMINISTRATËS**
 - 5.3. NDËRTESAT E SEKTORIT TË ARSIMIT**
 - 5.4. NDËRTESAT E SEKTORIT TË SHËNDETËSISË**
 - 5.5. NDËRTESAT E SEKTORIT KULTURË DHE SPORT**
 - 5.6. NDËRTESAT E SEKTORIT REZIDENCIAL**
 - 5.7. NDRIÇIMI PUBLIK**
 - 5.7.1. STRUKTURA E PËRGJITHSHME E NDRIÇIMIT PUBLIK**
 - 5.8. TRANSPORTI**
- 6. POTENCIALI PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**
 - 6.1. MASAT LEGJISLATIVE DHE ORGANIZATIVE**
 - 6.2. MASAT TEKNIKE (RENOVIMET NË NDËRTESAT DHE NDRIÇIM PUBLIK)**
 - 6.2.1. POTENCIALI PËR KURSIM NË SEKTORIN E NDËRTESAVE PUBLIKE DHE NDRIÇIM PUBLIK**
 - 6.3. PËRFITIMET SHITESË**
- 7. PLANI I VEPRIMIT**
 - 7.1 MASAT ORGANIZATIVE**
 - 7.2. KORNIZA KOHORE DHE FINANCIARE PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE TË IDENTIFIKUARA**
- 8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

PARATHËNIE

PKEE duhet të miratohet nga autoritetet përkatëse komunale dhe palët e interesuara si partnerët socialë, autoritetet rajonale dhe lokale, shoqatat përkatëse, partnerët teknologjik, bankat, institucionet financiare etj. (listat do të ndryshojnë nga komuna në komunë) në mënyrë që të bëhen pjesë e strategjisë komunale në këtë sektor.

Plani Komunal i Efiçencës së Energjisë (PKEE) është një pjesë thelbësore e pakos së dokumenteve të zhvillimit Komunal. Ai përfshin zhvillimin e komponentëve të përbashkëta në sistemet e ndryshme të energjisë. PKEE është një dokument strategjik, i cili shërben si udhërrëfyes për masat e mëtejme. Plani Komunal për Efiçencë të Energjisë është hartuar me qëllim të arritjes së caqeve të efiçencës së energjisë. Në plan janë përshkruar procedurat për Monitorim dhe Vlerësim. Strategjia ndiqet nga Plani i Veprimit i cili përfshinë:

- Veprime/Projekte konkretë të cilat duhet të zbatohen;
- Departamentet përgjegjëse për implementim;
- Resurset (administrative, financiare);
- Komunikimi dhe Bashkëpunimi.

PKEE i Vitisë ka përdorur rezultatet e analizës mbi gjendjen ekzistuese, me qëllim të identifikimit të fushave të nevojshme për veprim dhe mundësitë për të arritur caqet e kursimit të energjisë nga autoritetet lokale. Ai përcakton masa konkrete për kursim, së bashku me kornizat kohore dhe përgjegjësitë e caktuara, të cilat e zbërthejnë strategjinë afat-gjatë në veprime konkrete. Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese janë analizuar dhe përshkruar disa sektorë në këtë PKEE.

1. HYRJE

Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë në Kosovë (PKVEE) është dokument bazik për implementimin e politikave për eficiencë të energjisë në Kosovë. PKVEE i Kosovës (2010-2018) është miratuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik më 30 shtator 2011. Ai parasheh arritjen e caktimit indikator prej 9% të 1021.08 ktoe deri në fund të periudhës së mbuluar me plan (2010-2018). Prandaj, sasia e energjisë që Kosova synon të kursejë deri në vitin 2018 është 91.89 ktoe.

Për të arritur përmbushjen e PKVEE është hartuar Plani i Parë i Veprimit për Eficiencë të Energjisë në Kosovë 2010-2012 dhe Plani i Dytë i Veprimit për Eficiencë të Energjisë në Kosovë 2013-2015. Në përmbushjen e PKVEE kërkohet që kjo të bëhet nga të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Për arritjen e këtij qëllimi të gjitha komunat e Kosovës obligohen që të hartojnë Planin Komunal për Eficiencë të Energjisë. Në funksion të kësaj Komuna e Vitisë ka përgatitur Planin Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, i cili synon: përkrahjen e menaxhimit në nivel lokal të burimeve të energjisë dhe propozimin e mënyrave për përmirësimin e disponueshmërisë së energjisë.

Nëpërmjet vlerësimit të gjendjes energjetike të ndërtesave publike Komuna e Vitisë, synon të kryejë analizën për implementimin e masave të eficiencës së energjisë në Stokun e Ndërtesave të menaxhuara nga komuna.

Përvoja e komunave në Europës jug-lindore (EJL) dhe jashtë saj ofron dëshmi për përfitimet e mëdha financiare dhe sociale nga rritja e eficiencës së energjisë (EE) dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) nëpër komuna.

Eficienca e energjisë duhet të konsiderohet si një proces, ajo nuk përmban vetëm aktivitetet momentale për të arritur zvogëlimin e humbjeve të energjisë por ajo gjithashtu përfshinë monitorimin dhe kontrollimin e konsumit të energjisë me qëllim të arritjes së konsumit minimal të energjisë në vazhdimësi¹. Për të siguruar vazhdimësinë e implementimit të masave të EE, konsumi i energjisë duhet të menaxhohet si çdo aktivitet tjetër. Në fakt, menaxhimi i energjisë shërben për shmangien e përdorimit të energjisë së panevojshme dhe zvogëlimin e humbjeve të energjisë. Eficienca e energjisë merr parasyshë jovetëm tiparet tekno-ekonomike të konsumit të energjisë por ajo duhet të shndërrohet në një proces social në kontinuitet. Ndoshta hapësira më e lënë pas dore për implementimin është promovimi i ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me kostot dhe përfitimet e eficiencës së energjisë.

¹ Energy Efficiency , Jenny Palm, Rijeka, Croatia 2012

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani Komunal i Efiçencës së Energjisë (PKEE) tashmë është një obligim ligjor. Nisur nga kjo dhe nga interesi i pakontestueshëm i Komunës, udhëheqja komunale kishte vendosur zhvillimin e tij.

Është imperativ kohe formimi i zyrës Komunale për efiçencë të energjisë apo edhe Ekipit Komunal për Efiçencë të Energjisë i cili profesionalisht do të merrej me potencialin e efiçencës së energjisë dhe do të analizohen përfitimet në buxhetin e komunës, bizneseve si dhe qytetarëve nga zbatimi i masave për efiçencë të energjisë.

2.1 OBJEKTIVAT E PKEE

Objektivat e përgjithshëm të PKEE-së janë që të reduktojë konsumin e energjisë në Stokun e Ndërtesave, transport dhe ndriçim publik si dhe, sipas kërkesës, në funksionimin e shërbimeve komunale përmes reduktimit të barrës së kostos së energjisë në buxhetet komunale. PKEE pritet që në vijim të ketë ndikim në gjendjen e Komunës së Vitisë dhe atë në:

- Përmirësimin e shërbimeve komunale;
- Reduktimin e kostove të energjisë në buxhetin komunal;
- Renovimin e sistemeve të energjisë dhe ndërtesave;
- Përmirësimin e kushteve sanitare dhe rritjen e produktivitetit;
- Ngritjen e vetëdijes për kursimin e energjisë tek vendimmarrësit, operatorët dhe përdoruesit fundorë;
- Reduktimin e emetimeve të dëmshme nga përdorimi i burimeve të energjisë.

2.1.1. KORNIZA LIGJORE

Masat e parashikuara në PKEE janë në përputhje me ligjet përkatëse që rregullojnë fushën e energjisë, Planin e Veprimit Mjedisor dhe me rregulloret komunale. Veçanërisht me:

1. Ligjin për Energjisë (03/L-184) - Përcakton rolin e qeverisjes lokale sa i përket obligimeve në fushën e energjisë: Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë e Energjisë;

2. Strategjinë e energjisë, Programin për Zbatimin e Strategjisë së energjisë dhe balanceve të energjisë;

3. Ligjin për Efiçencën e Energjisë - Ligji i Kosovës për Efiçencën e Energjisë (ligji Nr. 04/L-016) përcakton përgjegjësitë e reja që do të kenë komunat në të ardhmen e afërt në lidhje me

menaxhimin e energjisë dhe ujit dhe çështjet e lidhura me ato. Sipas këtij ligji, institucionet arsimore, të shëndetit publik, shërbimit social dhe të tjera së bashku me veprimet e mbrojtjes mjedisore, do të jenë nën bashkëpërgjegjësinë e qeverisjes lokale dhe qendrore. Gjithashtu, komuna është përgjegjëse për projektimin dhe implementimin e politikave rajonale, e cila është një atribut i rëndësishëm në lidhje me politikën energjetike.

4. Direktivat Evropiane, veçanërisht direktiva 2006/32/EC - Kërkesat primare të kësaj Direktive janë:

- harmonizimi i metodave të llogaritjes për efiçencën e energjisë nëpër ndërtesa, sipas një strukture të plotë të kontabilitetit;
- imponimi i kërkesave minimale për ndërtesat e reja dhe për tërë rindërtimin;
- krijimi i certifikimit të detyrueshëm energjetik të ndërtesave dhe
- krijimi i një inspektimi të rregullt të sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes.

3. PËRSHKRIMI I KOMUNËS SË VITISË

3.1 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Komuna e Vitisë, me një sipërfaqe prej rreth 270 km², shtrihet në juglindje të Republikës së Kosovës. Në verilindje kufizohet me komunën e Gjilanit, në perëndim me komunën e Ferizajit, në jugperëndim me komunën e Kaçanikut dhe krejtësisht në juglindje kufizohet me Republikën e Maqedonisë.

Kjo komunë ka 39 vendbanime, 38 fshatra dhe qyteti i Vitisë.

Komuna e Vitisë sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011 ka 7496 banesa (shtëpi), 7520 ekonomi familjare dhe 46987 banorë.

Tabela 1. Banesat dhe ndërtesat sipas komunave²

| Viti | Gjithsej banesa ekonomi familjare dhe persona sipas tipit të vendbanimit | | | | | | | | |
|---------------------|--|-------------------|---------|--------|-------------------|---------|--------|-------------------|---------|
| | Gjithsej | | | Urban | | | Rural | | |
| | Banesa | Ekonomi familjare | Persona | Banesa | Ekonomi familjare | Persona | Banesa | Ekonomi familjare | Persona |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| | 7,496 | 7,520 | 46,987 | 893 | 895 | 4,924 | 6,603 | 6,625 | 42,063 |
| Banesa të zakonshme | 7,491 | 7,515 | 46,953 | 893 | 895 | 4,924 | 6,598 | 6,620 | 42,029 |
| Lloj tjetër banesë | 5 | 5 | 14 | - | - | - | 5 | 5 | 14 |

² Banesat dhe ndërtesat sipas komunave, regjistrimi i popullsisë 2011, ASK

3.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMUNËS SË VITISË

Kuvendi i Komunës është organi legjislativ i komunës, i cili ushtron funksionet qeverisjes lokale të përcaktuara me rregullore dhe statut. Kuvendi Komunal i Vitisë, përbëhet nga 27 këshilltarë. Administrata komunale është organ i kuvendit komunal dhe implementon vendimet e kuvendit. Administrata Komunale është përgjegjëse për implementimin e të gjitha detyrave ekzekutive të caktuara me statut dhe me aktet e tjera normative.

Shërbimet e Komunës së Vitisë te qytetarët janë të ndryshme dhe të shumta, duke filluar nga rregullimi i dokumenteve të statusit civil deri në projektet kapitale.



Foto. 1. Sheshi i qytetit "Njazi Azemi"

3.3. VIZIONI DHE QËLLIMI

Vizioni i Komunës për një periudhë afatmesme përbëhet nga shërbimet e përmirësuara komunale duke ngritur vetëdijen tek qytetarët për përdorimin e energjisë në mënyrë efiçiente. Kjo do të arrihej duke bërë intervenime për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë fillimisht në objektet publike komunale, konsumatorët e amvisërisë si dhe te bizneset, po ashtu edhe në ndriçimin e rrugëve përmes ndriçimit me sistem solar të qytetit për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ambient të brendshëm komfort në ndërtesa, konsumin më të vogël të energjisë dhe efekte mjedisore të zvogëluara.

Për të arritur qëllimin e Komunës, përmes këtij projekti synohet të punohet në azhurnimin e të dhënave tremujore për konsum të energjisë elektrike, ujit dhe ngrohjes në çdo ndërtesë komunale, duke krijuar mundësinë e klasifikimit të ndërtesës me prioritet. Për të arritur qëllimet e veta, Komuna e Vitisë do të kontrakttoj specialistë për të kryer auditimet e energjisë së ndërtesave. Për të financuar projektet e efiçencës së energjisë, Komuna e Vitisë do të angazhohet në mbledhjen e fondeve duke përdorur mekanizma të ndryshëm financiar vendor dhe të huaj.

Për implementimin e PKEE-së, është e nevojshme për të planifikuar një fond në buxhetin e vitit të ardhshëm për një qëllim specifik të implementimit të projekteve për efiçencën e energjisë dhe përdorimin e energjisë së ripërtëritshme, duke përfshirë jo vetëm investimet e veçanta, por edhe fushatat e vetëdijesimit të energjisë. Trajnimi i Ekipit të Efiçencës së Energjisë në komunë është shumë i rëndësishëm.

3.4. MENAXHIMI I ENERGJISË NË KOMUNË

Komunat në vendin tonë sipas kornizës ligjore nuk menaxhojnë me resurset energjetike. Kjo është përgjegjësi e kompanive qendrore energjetike publike/private, por autoritetet komunale në këtë rast komuna e Vitisë mund të ketë përfitime të rëndësishme duke orientuar politikat e saj zhvillimore drejt përmirësimit të efiçencës së energjisë si dhe përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Përgjegjësitë e komunës në lidhje me qytetarët dhe shërbimeve ndaj tyre janë të shumta. Komuna është përgjegjëse për mbarëvajtjen e administratës komunale, mbarëvajtjen e arsimit parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Komuna ka përgjegjësi për nivelin primar shëndetësor. Gjithashtu në lëmin e infrastrukturës komuna ofron mirëmbajtjen e vazhdueshme për ndriçimin e rrugëve nën konditat e rritjes së vazhdueshme të segmenteve të ndriçuara.

Në formë të përgjithshme, komuna është përgjegjëse për të ngrohjen, ndriçimin, pajisjet specifike dhe administrative, ujin e ngrohtë të të gjitha ndërtesave shëndetësore primare, ndërtesave shkollore, ndërtesave administrative, kulturore dhe sportive në territorin e saj.

Spektori i banimit është mjaft i ndjeshëm dhe vital për komunën, por kompetencat komunale nuk depërtojnë deri tek menaxhimi i energjisë në këto ndërtesa. Përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të energjisë elektrike është kompania e distribuimit të energjisë elektrike KEDS.

Në aspektin e energjisë për ngrohje, në komunë nuk ekziston një ngrohtore e qytetit. Ngrohtorja e qytetit do të zvogëlonte dukshëm konsumin e energjisë në komunë si në sektorin privat ashtu edhe atë publik.

3.5. ÇKA ËSHTË PLANI KOMUNAL PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

PKEE për zhvillim të qëndrueshëm të qytetit / komunës është dokumenti bazë mbi bazën e treguesve të grumbulluar të energjisë për vitin referencë i cili identifikon dhe jep udhëzime të sakta dhe të qarta për zbatimin e projekteve dhe të masave të efiçencës së energjisë dhe energjisë së rinovueshme në nivel lokal, të cilat do të çojnë në një reduktim të emetimeve të CO₂ për më shumë se 20% deri në vitin 2020.'

4. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË NË KOMUNËN E VITISË

Në lidhje me konsumin e energjisë në komunën e Vitisë deri më tani nuk janë kryer studime apo përmbledhje të të dhënave gjithëpërfshirëse në lidhje me konsumin përfundimtar të energjisë. Në komunë nuk ekziston zyra për energji apo edhe menaxher i energjisë me detyrë të vetme hartimin e planeve dhe projekteve për kursimin e energjisë, por ka vetëm koordinator për energji i cili krahas detyrave tjera të përcaktuara ka edhe detyrat mbi EE.

Energjia elektrike e konsumuar në komunën e Vitisë është ekskluzivisht e furnizuar nga rrjeti shpërndarës 0.4KV dhe distributori KEDS. Ndriçimi i rrugëve është i kyçur tërësisht në rrjetin ekzistues elektrik dhe nuk ka trupa ndriçues të lidhur me burime të ripërtëritshme solar (PV).

Ndërtesat komunale kanë në shumicën e rasteve kaldajat e tyre vetanake për ngrohje të cilat përdorin kryesisht drurin, derivatet e naftës dhe thëngjillin si lëndë për djegie apo edhe energjinë elektrike.

Ndërtesat rezidenciale përdorin drurin dhe thëngjillin si lëndë për djegie por edhe energjinë elektrike. Aktualisht nuk ka sistem të gazit të instaluar në forma rrjeti komunal dhe as lokal në ndërtesa, si dhe nuk ka burime alternative për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme.

4.1. FURNIZIMI ME ENERGJI I KOMUNËS SË VITISË

Furnizimi me energji elektrike bëhet nga kompanitë energjetike KOSTT (kompani publike) dhe KEDS (kompani e privatizuar). KOSTT-i që manaxhon me linjat e tensioneve të larta të transmetimit të energjisë në nivelet e tensionit 110kV, 220kV dhe 400kV, ndërsa KEDS manaxhon furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike si dhe mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë në nivelet e tensionit 35kV, 10kV dhe 0.4kV. Komuna e Vitisë me rrethinë furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni NS 110/35/10 kV Vitia, nëpërmes dy linjave 110kV, njëra linjë nga NS 110/35/10kV Gjilani 1 dhe tjetra nga NS 110/0.6 kV Sharr-Cemi. Nënstacioni NS 110/35/10 kV Vitia ka kapacitet transformues prej 2x20 MW, me ngarkesë maksimale 26.7MW, nga i cili furnizohen me energji elektrike dy nënstacione:

1. NS 35/10 kV Rrafshina me fuqi të instaluar 2x8MVA, furnizohet nga nënstacioni NS 110/35/10 kV Rrafshina me kapacitet transformues prej 2x20 MW, me ngarkesë maksimale në

muajin Dhjetor 2014 prej 11MW dhe harxhim mujor 4,639,000 kWh. Nga ky nënstacion bëhet furnizimi i konsumatorëve të komunës së Vitisë nëpërmjet 6 linjave 10kV: Vitia, Begunca, Stublla, Germova, Smira dhe Binqa.

2. NS 35/10 kV Kllokoti me fuqi të instaluar 2x8 MVA, me ngarkesë maksimale në muajin Dhjetor 2014 14.3 MW dhe harxhim mujor 6,621,023 kWh. Nga ky nënstacion bëhet furnizimi i pjesës tjetër të konsumatorëve nëpërmjet 8 linjave 10 kV: Pozharani, Sllatina, Kllokoti-Skifteraj, Terpeza, Industriali, Vineksi, Jeta dhe Stacionari. Këto linja 10 kV janë të shpërndara nëpër qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunës së Vitisë, e që në fund energjia e distribuar të konsumatorët transformohet në nivelin 400V nëpërmes trafostacioneve distributive 10(20)/0.4kV.

4.1.1. SIGURIA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

Furnizimi me energji elektrike i Vitisë si edhe në tërë vendin tonë ballafaqohet me probleme të shumta, si pasojë e avarive në blloqet e termocentraleve të Kosovës A dhe Kosovës B, kemi ndërprerje të energjisë me orë të tëra sidomos gjatë sezonës së dimrit, edhe pse në vitet e fundit situata është përmirësuar ndjeshëm. Gjithashtu kemi ndërprerje të shpeshta të energjisë edhe në rrjetin e shpërndarjes, rrjeti kryesisht është me sistem radial (linjat të furnizuara prej vetëm një burimi). Pra, nuk ka lidhje unazore ndërmjet linjave distributive dhe detyrimisht me rastin e defekteve në rrjet ato mbetin pa energji deri në sanimin e tyre nga ekipet e mirëmbajtjes. Frekuenca e avarive në rrjetin e tensionit të ulët është shumë më e lartë se në rrjetin e tensionit të mesëm e të lartë. Tensioni i ofruar te konsumatorët fundor nuk është në nivelin e kërkuar, si pasojë e rrjetit të vjetëruar e sidomos në vendbanimet jashtë qytetit për shkak të gjatësive të mëdha të linjave.

4.2. KONSUMUESIT E FUNDËM TË ENERGJISË

Si konsumues të energjisë në komunën e Vitisë janë identifikuar si më poshtë:

- Ndërtesat komunale (në pronësi të komunës);
- Ndërtesat terciare (jo në pronësi të komunës);
- Ndërtesat rezidenciale;
- Ndriçimi publik;
- Transporti.

Meqenëse për ndërtesat terciare jo në pronësi të komunës (gjykata, policia, spitali etj) komuna nuk ka përgjegjësi për pagesën e konsumit të energjisë apo edhe mirëmbajtjen e tyre, këto ndërtesa nuk janë marrë në konsiderim.

4.3. STOKU I NDËRTESAVE NË MENAXHIM TË KOMUNËS SË VITISË

Ndërtesat publike në sektorin e shërbimeve të Komunës së Vitisë përfshijnë: ndërtesat e shëndetit publik, ndërtesat e institucioneve arsimore, ndërtesat kulturore, ndërtesat e institucioneve të hulumtimeve të ndryshme, ndërtesat ushtarake, ndërtesat e institucioneve

administrative lokale dhe qendrore, ndërtesat gjyqësore, etj. shumica e këtyre ndërtesave i përkasin sektorit publik. Në të ardhmen, zhvillimi i nën-sektorit të shërbimeve për tërë Kosovën në përgjithësi dhe në veçanti për Komunën e Vitisë (e cila përfshin ndërtesat publike) do të kërkojnë për përmirësime të ndjeshme në infrastrukturë dhe kushte më të mira për kryerjen e veprimeve përkatëse. Të gjitha këto çështje do të sjellin një rritje të kërkesës së energjisë (sidomos për realizimin e ngrohjes, ujit të ngrohtë, ftohjes) sipas veçantive të mëposhtme për secilën kategori të ndërtesës publike dhe ato janë shumë të rëndësishme.

Komuna e Vitisë sikurse edhe komunat tjera në territorin e Republikës së Kosovës ka një stok të ndërtesave karakteristik për periudhën e ndërtimit. Bazuar në studimin e BB "Studimi i Kosovës për ngrohje" periudhat e më poshtme definojnë në bazë të vitit të ndërtimit si:

Periudha 1: Ndërtesat e ndërtuara deri në vitin 1959. Parimisht periudha e ish RFJ-së - Kjo periudhë përfshinë stokun e ndërtesave të ndërtuara para vitit 1959. Këto ndërtesa janë karakterizuar me mure të trasha të ndërtuara me tulla të ngurta, dritare të dyfishta, dysheme nga druri pa izolim termik dhe tavanet me trer të përbërë nga druri.

Periudha 2: Ndërtesat e ndërtuara gjatë viteve 1960 dhe 1998 - Ndërtesat publike të ndërtuara përgjatë viteve 1960-1979 karakterizohen me strukturë të re skeletore të përforcuara me beton. Muret janë zakonisht 25 deri në 30 cm të trasha me hapje më të mëdha, qelqi është përdorë në masë të madhe në krahasim me masën e plotë. Struktura e ndërtimit të banesave shumë katëshe gjatë kësaj periudhe ka bërë prezantimin e parafabrikimit të paneleve, në këtë sektor të ndërtimit por nuk është se janë aplikuar në një masë të gjerë. Blloqet e zbratura ishin elementi më i zakonshëm për ndërtim. Izolimi termik nuk është aplikuar edhe kur janë dizajnuar ato. Gjatë viteve të 80-ta me futjen e kodit të ri JUS i cili kërkon U (vlerën) $< 1.25 \text{ W/m}^2\text{K}$, filloj aplikimi i mureve kompaktë/të përbëra. Këto ndërtesa janë ndërtuar kryesisht në çdo qytet në Kosovë në formë të shkollave, qendrave shëndetësore familjare, Kopshtet e fëmijëve, Administrata etj. Ato karakterizohen me dritare të mëdha që shtrihen nga 1/2 e fasadës të ndërtesave, kulme të sheshtë dhe fasada të pa izoluar. Sa i përket EE, këto ndërtesa janë konsumues të mëdhenj të energjisë për shkak të raportit qelq/mur, urave termike, mbështjellësi i pa izoluar etj. Në anën tjetër ka edhe një potencial të madh për kursim të energjisë dhe sa herë që të jetë e mundur gjatë zbatimit të EE – masa e xhamit duhet të reduktohet dhe zëvendësohet me mure të izoluar.

Periudha 3: Ndërtesat e ndërtuara gjatë vitit 1999 – 2001 - Gjendja Emergjentë e periudhës së pasluftës - Periudha emergjentë ose periudha e pas luftës e kishte si prioritet strehimin. Rinovimet e Periudhës emergjentë në Kosovë u zhvilluan në mënyrë jo profesionale dhe me materiale të cilësisë tejet të dobët. Muret ishin lënë të pa izoluar ndërsa izolimin termik ishte instaluar vetëm në tavane të reja për shkak se ajo ishte më pak e shtrenjtë se sa ndërtimi i çatave të reja. Mirëpo ka raste në të cilat as tavanit nuk është izoluar. Dritaret gjatë periudhës Emergjentë janë prodhuar nga druri i lagësht të cilat menjëherë pas montimit që në vitin e parë janë plasaritur për shkak të cilësisë së dobët. Aktualisht, këto dritare nuk mbyllen siç duhet dhe era depërton përtej tyre. Dyshemetë gjatë kësaj periudhe ishin të mbuluara vetëm me dërrasa druri të cilat janë kalbur gjatë viteve të para të instalimit. Në mënyrë që të zgjatët ciklin e tyre i

jetës, personeli i kishte lyer këto dysHEME me vaj motorik. Një veprim i tillë nuk është i ligjshëm dhe është i rrezikshëm për shëndetin, por që ishte një domosdoshmëri deri në renovimin e ardhshëm.

Periudha 4: Ndërtesat e ndërtuara pas vitit 2002. Fundi i periudhës emergjentë dhe kohet e fundit - Kjo periudhë përfshinë ndërtesat e reja të ndërtuara nga viti 2003 deri në ditët e sotme. Masat e izolimit termik janë zbatuar pothuajse në të gjitha ndërtesat publike të ndërtuara gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, sektori rezidencial ka pasur specifika të ndryshme në lidhje me kursimin e energjisë. Banesat shumëkatëshe janë ndërtuar në përputhje me standardet shtetërore, ndërsa shumica e shtëpive individuale nuk i zbatojnë masat e kursimit të energjisë.

4.3.1. REKOMANDIM I PËRGJITHSHEM NË LIDHJE ME STOKUN E NDËRTËSAVE PUBLIKE

Stoku ekzistues i ndërtesave publike është në kushte shumë të këqija sa i përket termoizolimit, si pasojë të gjitha institucionet energjetike të angazhuara në kursimet e energjisë duhet të kenë këtë çështje si problem crucial siç është përshkruar në Strategjinë e Energjisë së Kosovës dhe Plani Nacional i Kosovës për Efiçencën e Energjisë.

Përmirësimi i stokut ekzistues të ndërtesave nga këndvështrimi termoizolues dhe ndërtimi i ndërtesave të reja publike duke u bazuar në kodin e ri energjetik (që është duke u përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) do të mundësojë kursimin e burimeve të energjisë që përdoren për ngrohje dhe ftohje. Në anën tjetër, kursimi i energjisë i cili rezulton si pasojë e instalimit të izolimit termik do të mundësojë përdorimin e burimeve më të pakta të energjisë për të përmbushur nevojat e ngrohjes.

5. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË

Shpenzuesit kryesor të energjisë të identifikuar në komunën e Vitisë janë:

- Sektori i ndërtesave komunale publike me këto ndërtesa/objekte:
 - Administrative,
 - Arsimore,
 - Shëndetësore,
 - Kulturore-sportive.
- Sektori i ndërtesave rezidenciale;
- Sektori i ndriçimit publik;
- Sektori i transportit.

Ndarja në këto kategori është bërë për të marrë një pasqyrë më të mirë dhe më të saktë në konsumin aktual të ngrohjes dhe energjisë elektrike të objekteve të sektorit në pronësi të komunës në lidhje me aktivitetet që kryhen në ndërtesa. Të dhënat e grumbulluara, në sektorët e ndërtesave në pronësi të komunës janë paraqitur me parametrat e mëposhtëm:

- Informata të përgjithshme në lidhje me sektor;
- Sipërfaqja e përgjithshme e sektorit (m²);
- Numri i objekteve për sektor;
- Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike dhe termike për sektor (kWh);
- Konsumi specifik i energjisë elektrike dhe termike për sektorin (kWh/m²);

- Konsumi i përgjithshëm i drurit (m³);
- Konsumi i përgjithshëm i mazutit, naftës (l);


Duhet theksuar se të gjitha të dhënat të dhëna për analizën e konsumit të energjisë të mbledhura nga departamenti përkatës administrativ, plotësisht të besueshme dhe të sakta.

5.1. SHPËRNDARJA E ENERGISË SIPAS KONSUMIT

Sipas MZHE³ shpërndarja e konsumit të energjisë është e ndryshme për lloje të ndryshme të ndërtesave publike. Të gjeturat nga studimi i kryer në vitin 2012 janë dhënë me anë të figurave mëposhtëm dhe mund të shërbejnë si bazë për investimet e ardhshme në lidhje me reduktimin e konsumit të energjisë varësisht se ku është kërkesa më e madhe.


a) Administrata

Figura 2. Shpërndarja konsumit të energjisë të ndërtesat administrative



b) Arsimi


Figura 3. Shpërndarja konsumit të energjisë të ndërtesat arsimore



³ MZHE, Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve

c) Shëndetësia

Figura 4. Shpërndarja e konsumit të energjisë në ndërtesat shëndetësore



5.2. NDËRTE SAT E SEKTORIT TË ADMINISTRATËS

Në Komunën e Vitisë si objekte të administratë publike janë identifikuar 12 ndërtesa. Në tabelën e mëposhtme janë renditur objektet e administratës për të cilat janë grumbulluar të dhënat që paraqesin: Emertimin e ndërtesës, Adresën, Sipërfaqen, Shpenzimin vjetor të energjisë elektrike në kWh (për vitet 2012, 2013, 2014), Shpenzimin mesatar vjetor të energjisë elektrike në kWh si dhe konsumin specifik.

Konsumi total për energji elektrike është **332,285 kWh**, ndërsa konsumi total për energji termike është **279,257 kWh**, totali i energjisë elektrike dhe termike është **611,542.29 kWh**. Totali i sipërfaqeve të objekteve të administratës është **9725 m²**.

Në bazë të llogaritjeve konsumi specifik mesatar për tre vitet për objektet e administratës është **125 kWh/m²/vit**.

Nga vlerësimet e bëra shihet janë 5 objekte të cilat tejkalojnë konsumin e energjisë prej 100 kWh/m²/vit (Shërbimi i Ofiqarisë 246 100 kWh/m²/vit, K.Komunal 321 100 kWh/m²/vit, K.Komunal 270 100 kWh/m²/vit, K.Komunal 268 100 kWh/m²/vit, Planifikimi hapsinor Kuvendi Komunal Idriz Seferi 106 100 kWh/m²/vit).

Nga vlerësimet e bëra shihet se kemi konsum të lartë në ndërtesat e komunës së Vitisë që ofrojnë shërbime gjatë gjithë javës dhe me orar të plotë të punës, ndërsa më të ulët në ndërtesa tjera. Konsumi është më i lartë sepse te këto ndërtesa ofrohen shërbime gjatë tërë orarit të punës, ndërsa ndërtesat tjera nuk ofrojnë shërbime gjatë gjithë ditës, por vetëm gjatë ditëve të caktuara dhe me orar të caktuar. Konsumi i ulët i energjisë në këtë ndërtesa nuk i bën më shumë eficiente se ato që konsumojnë energji më shumë. Për të fituar të dhëna më të sakta për performancën energjetike të ndërtesave rekomandohet që të bëhet Auditimi i energjisë.


Ndërtesat e administratës në komunën e Vitisë janë në gjendje jo të mirë sa i përket efiçencës së energjisë. Në ndërtesë nuk ka komfor të brendshëm si në aspektin e ngrohjes ashtu edhe atë të ndriçimit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur këto objekte dhe për secilën janë paraqitur të dhënat karakteristike për konsumin e energjisë.

Tabela 5. Ndërtesat e Sektorit të Administratës

| Nr. | EMËRTIMI I NDËRTESES | ADRESA / VENDI | SIPË RFA QE m2 | SHPENZIMI VJETOR | | | SHPENZIMI MESATAR VJETOR | | |
|-----|---|----------------|----------------|------------------------------|------------------------------|------------------------------|--------------------------|-----------------------|-----------------------------|
| | | | | Energji Elektrike (kWh) 2012 | Energji Elektrike (kWh) 2013 | Energji Elektrike (kWh) 2014 | ENERGJI ELEKTRIKE (kWh) | ENERGJI TERMIKE (kWh) | Konsumi specifik kWh/m2/vit |
| 1 | Sherbimi i Ofiqarise | Viti | 260 | 38,105.90 | 36,834.19 | 31,192.76 | 21,727 | 42,345 | 246 |
| 2 | K. Komunal | Viti | 379 | 37,854.19 | 36,248.67 | 52,876.10 | 32,168 | 89,324 | 321 |
| 3 | K. Komunal | Viti | 379 | 51,758.48 | 52,843.33 | 47,343.71 | 31,283 | 71,067 | 270 |
| 4 | K. Komunal | Viti | 379 | 19,765.43 | 32,702.19 | 26,127.71 | 24,929 | 76,521 | 268 |
| 5 | Enti i Gjeodosisë | Viti | 675 | 36,384.67 | 33,863.05 | 28,418.38 | 29,714 | - | 44 |
| 6 | Shtepia e Kultures "Gursel dhe Bajram Sylejmani" | Viti | 6147 | 278,676.57 | 101,787.52 | 197,979.81 | 94,402 | - | 15 |
| 7 | Tmk Zyret | Viti | 460 | 80,786.38 | 90,545.62 | 59,444.86 | 45,180 | - | 98 |
| 8 | Seksioni pyjor | Viti | 156 | 8,812.38 | 8,113.05 | 7,061.52 | 2,599 | - | 17 |
| 9 | Bibloteka-Pozhoran | Pozhara n | 250 | 8,007.14 | 6,805.81 | 6,865.71 | 5,639 | - | 23 |
| 10 | Planifikimi hapsinor kuvendi komunal Idriz Seferi | Viti | 120 | | 7,256.67 | 18,276.19 | 12,766 | - | 106 |
| 11 | Qendra për informim dhe turizem | Pozhara n | 85 | | | 4,376.67 | 1,520 | - | 18 |

| | | | | | | | | | |
|---------------|---------------------------|------|-------------|-------------------|-------------------|-------------------|----------------|----------------|-------------|
| 12 | Objekt I partive politike | Viti | 435 | 0.00 | 29,244.95 | 31,474.10 | 30,360 | - | 70 |
| TOTALI | | | 9725 | 560,151.14 | 436,245.05 | 511,437.52 | 332,285 | 279,257 | 1496 |

 Figura 5. Konsumi i energjisë për nënsektorin e Arsimit shprehur si konsum specific (kWh/m²/vit)


5.3. NDËRTESTAT E SEKTORIT TË ARSIMIT

Në sektorin e arsimit ne komunën e Vitisë janë identifikuar 42 objekte shkollore. Në tabelën e mëposhtme janë renditur objektet e sektorit te arsimit për të cilat janë grumbulluar të dhënat që paraqesin: Emertimin e nderteses, Adresën, Sipërfaqen, Shpenzimin vjetor te energjisë elektrike në kWh (për vitet 2012, 2013, 2014), Shpenzimin mesatar vjetor te energjisë elektrike ne kWh si dhe konsumin specific.

Konsumi total për energji elektrike është **846,664 kWh**, ndërsa konsumi total për energji termike është **3,750,205 kWh**, totali i energjisë elektrike dhe termike është **4,596,870 kWh**. Totali i sipërfaqeve të objekteve të administratës është **41622 m²**.

Në bazë të llogaritjeve konsumi specific mesatar për tre vitet për objektet e adminstratës është **120 kWh/m²/vit**.

Nga vlerësimet e bëra shihet janë 20 objekte të cilat tejkalojnë konsumin e energjisë prej 100

kWh/m²/vit. Objekti që ka konsumin më të madh në objektet e arsimit është Qerdhja Gëzimi i Ynë me 485 kWh/m²/vit. Përveq këtij objekti janë shumica e këtyre objekteve në të cilat duhet të implementohen masat për kursim të energjisë, sepse në disa shkolla edhe pse ka dalë konsumi i ulët në këto shkolla nuk ka komfor energjetik, i cili është i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për këto objekte të këtij sektori. Konsumi i ulët i energjisë në këtë ndërtesa nuk i bën më shumë eficiente se ato që konsumojnë energji më shumë. Për të fituar të dhëna më të sakta për performancën energjetike të ndërtesave rekomandohet që të bëhet Auditimi i energjisë.

Në bazë të llogaritjeve konsumi specifik mesatar për tre vitet për objektet e arsimit është 120kWh/m²/vit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur këto objekte dhe për secilën janë paraqitur të dhënat karakteristike për konsumin e energjisë.

Tabela 6. Ndërtesat e Sektorit të Arsimit

| Nr | EMËRTIMI I NDËRTESESË | ADRESA / VENDI | VITI I NDËRTIMIT | SIPËRFAQJA m ² | SHPENZIMI VJETOR | | | SHPENZIMI MESATAR VJETOR | | |
|----|-------------------------------|----------------|------------------|---------------------------|------------------------------|------------------------------|------------------------------|--------------------------|-----------------------|--|
| | | | | | ENERGJI ELEKTRIKE (kWh) 2012 | ENERGJI ELEKTRIKE (EUR) 2013 | ENERGJI ELEKTRIKE (kWh) 2014 | ENERGJI ELEKTRIKE (kWh) | ENERGJI TERMIKE (kWh) | Konsumi specifik kWh/m ² /vit |
| 1 | Shfmu,,Halil Alidema" | Pozhoran | 1949 | 2394 | 7,574 | 8,509 | 8,650 | 8,244 | 152,148 | 64 |
| 2 | Shfmu,,Halil Alidema" | Qifllak | 2004 | 440 | 686 | 653 | 225 | 521 | 18,509 | 42 |
| 3 | Shfmu,,Mirali Sejdiu" | Goshicë | 1984 | 1135 | 3,352 | 3,316 | 2,173 | 2,947 | 63,656 | 56 |
| 4 | Shfmu,,Mirali Sejdiu" | Gërmovë | 2005 | 1468 | 7,041 | 6,911 | 8,721 | 7,558 | 75,013 | 51 |
| 5 | Shfmu,,Skender Emerllahu" | Ramjan | 1986 | 920 | 4,879 | 4,937 | 7,101 | 5,639 | 46,112 | 50 |
| 6 | Shfmu,,Vëllezërit Gërvalla" | Buzovik | 1989 | 340.4 | 878 | 925 | 460 | 755 | 54,718 | 161 |
| 7 | Shfmu,,Vëllezërit Gërvalla" | Lubishtë | 2007 | 1215 | 7,149 | 7,435 | 11,882 | 8,822 | 116,750 | 96 |
| 8 | Shfmu,,Vëllezërit Gërvalla" | Podgorc | 1985 | 450 | 1,250 | 1,261 | 1,398 | 1,303 | 41,776 | 93 |
| 9 | Shfmu,,Dëshmoret e 5 Prillit" | Smirë | 1982 | 1749 | 5,682 | 5,675 | 10,329 | 7,229 | 142,138 | 81 |
| 10 | Shfmu,,Njazi Rexhepi" | Trestenik | 1985 | 364.9 | 871 | 881 | 448 | 733 | 54,697 | 150 |


PLANI KOMUNAL PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË 2016 – 2020

| | | | | | | | | | | |
|----|----------------------------|---------------------|------|-------|--------|--------|--------|--------|---------|-----|
| 11 | Shfmu,,Njazi Rexhepi" | Sllatine e Poshtme | 2004 | 605.5 | 1,269 | 1,317 | 1,109 | 1,232 | 61,940 | 102 |
| 12 | Shfmu,,Njazi Rexhepi" | Sllatinë e Eperme | 2004 | 449.9 | 1,345 | 1,354 | 1,160 | 1,286 | 61,995 | 138 |
| 13 | Shfmu,,Njazi Rexhepi" | Sllatinë e Eperme | 2014 | 1235 | 2,183 | 2,178 | 3,482 | 2,614 | 110,541 | 89 |
| 14 | Shfmu,,Njazi Rexhepi" | Sadovine e Qerkezve | 2002 | 190.3 | 817 | 881 | 627 | 775 | 41,247 | 217 |
| 15 | Shmp,,Jonuz Zejnullahu" | Viti | | 1138 | 16,621 | 18,637 | 13,041 | 16,100 | 285,919 | 251 |
| 16 | Shfmu,,Dëshmoret e Vitisë" | Viti | 2010 | 4000 | 8,955 | 8,962 | 17,410 | 11,776 | 214,140 | 54 |
| 17 | Shfmu,,Dëshmoret e Vitisë" | Drobesh | | 343.5 | 1,107 | 1,119 | 1,549 | 1,258 | 68,712 | 200 |
| 18 | Shfmu,,Safet Rexhepi" | Ballancë | 1988 | 196.7 | 1,630 | 1,638 | 1,266 | 1,511 | 55,475 | 282 |
| 19 | Shfmu,,Hasan Alia" | Remnik | 2010 | 1450 | 1,355 | 3,275 | 3,823 | 2,818 | 124,235 | 86 |
| 20 | Shfmu,,Kenan Halimi | Skifteraj | 2004 | 1749 | 5,762 | 5,780 | 5,612 | 5,718 | 113,646 | 65 |
| 21 | Shfmu,,28 Nëntori" | Vërban | 1989 | 1163 | 5,193 | 5,447 | 7,371 | 6,004 | 59,968 | 52 |
| 22 | Shfmu,,28 Nëntori" | Sodovine e Jerlive | 2005 | 645 | 4,310 | 4,394 | 5,194 | 4,633 | 85,578 | 133 |
| 23 | Shfmu,,Bafti Haxhiu" | Viti | 1990 | 2088 | 16,219 | 16,226 | 19,626 | 17,357 | 152,268 | 73 |
| 24 | Shfmu,,Bafti Haxhiu" | Ramnishtë | 2010 | 200 | 4,050 | 4,058 | 4,525 | 4,211 | 31,193 | 156 |
| 25 | Qerdhja „Gëzimi ynë" | Viti | 1977 | 200 | 45,290 | 44,973 | 38,638 | 42,967 | 96,938 | 485 |
| 26 | Shmgj,,Kuvendi I Lezhës" | Viti | 2014 | 3792 | 47,640 | 47,255 | 72,442 | 55,779 | 420,041 | 111 |
| 27 | Shmgj,,Kuvendi I Lezhës" | Pozhoran | 1949 | 1552 | 4,187 | 3,859 | 9,616 | 5,888 | 113,815 | 73 |
| 28 | Shfmu,,Ndre Mjeda" | Kabash | 1989 | 1259 | 10,850 | 10,822 | 5,881 | 9,184 | 130,603 | 104 |
| 29 | Shfmu,,Ndre Mjeda" | Binqë | 1986 | 116.9 | 593 | 618 | 505 | 572 | 14,063 | 120 |

PLANI KOMUNAL PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË 2016 – 2020

| | | | | | | | | | | |
|---------------|-------------------------------|------------------|------|--------------|----------------|----------------|----------------|----------------|------------------|-------------|
| 30 | Shfmu,,Don Mikel Tarabulluzi" | Stubëll e Eperme | 2001 | 1223 | 31,685 | 31,677 | 4,657 | 22,673 | 117,113 | 96 |
| 31 | Shfmu,,Nazmi Pajaziti" | Radivojc | 2008 | 1452 | 5,077 | 5,094 | 3,032 | 4,401 | 71,856 | 49 |
| 32 | Shfmu,,Nazmi Pajaziti" | Budrikë | 2008 | 475 | 3,323 | 3,302 | 1,904 | 2,843 | 56,807 | 120 |
| 33 | Shfmu,,Skender Emerllahu" | Fshati i ri | 2008 | 440 | 574 | 645 | 510 | 576 | 41,049 | 93 |
| 34 | Shfmu,,Nazmi Pajaziti" | Devajë | 1982 | 190.8 | 527 | 574 | 537 | 546 | 20,782 | 109 |
| 35 | Shfmu,,Ndre Mjeda" | Debelldeh | 1990 | 390 | 622 | 580 | 433 | 545 | 54,508 | 140 |
| 36 | Shf,,Mladen Markoviq" | Binçë | 1989 | 120 | 402 | 396 | 615 | 471 | 13,962 | 116 |
| 37 | Shfmu,,Hysen Terpeza" | Terpezë | 1985 | 1301 | 5,336 | 5,312 | 5,127 | 5,258 | 126,676 | 97 |
| 38 | Shfmu,,Don Mikel Tarabulluzi" | Letnicë | 1986 | 1434 | 288 | 269 | 799 | 452 | 27,434 | 19 |
| 39 | Shfmu,,Safet Rexhepi" | Zhiti | 1988 | 841.3 | 526 | 521 | 1,123 | 723 | 68,178 | 81 |
| 40 | Shf,,Mlladen Markoviq" | Viti | 1995 | 300 | 2,858 | 2,765 | 2,126 | 2,583 | 29,565 | 99 |
| 41 | Shf,,Mlladen Markoviq" | Binçë | 1989 | 301 | 2,719 | 2,774 | 2,967 | 2,820 | 31,151 | 103 |
| 42 | Shfmu,,Ahmet Hajdari' | Beguncë | 1988 | 303 | 2,854 | 2,810 | 1,372 | 2,345 | 83,290 | 275 |
| Totali | | | | 41622 | 289,465 | 280,016 | 275,530 | 281,670 | 3,750,205 | 5031 |

Figura 6. Konsumi i energjisë për nënsektorin e Arsimit shprehur si konsum specifik (kWh/m²/vit)



5.4. NDËRTESAT E SEKTORIT TË SHËNDETËSISË

Në sektorin e shëndetësisë janë identifikuar 12 objekte. Në tabelën e mëposhtme janë renditur objektet e sektorit të shëndetësisë për të cilat janë grumbulluar të dhënat që paraqesin: Emertimi i ndertesës, Adresën, Sipërfaqen, Burimin e energjisë (energji elektrike dhe energjia termike nga druri), Shpenzimin e energjisë (për vitet 2014, 2015), Shpenzimi vjetor mesatar.

Konsumi total për energji elektrike është **50,806 kWh**, ndërsa konsumi total për energji termike është **421,588 kWh**, totali i energjisë elektrike dhe termike është **472,393 kWh**. Totali i sipërfaqeve të objekteve të administratës është **4552 m²**.

Në bazë të llogaritjeve konsumi specifik mesatar për tre vitet për objektet e shëndetësisë është **83 kWh/m²/vit**.

Nga vlerësimet e bëra shihet se janë 6 objekte të cilat tejkalojnë konsumin e energjisë prej 100 kWh/m²/vit (QKMF në Viti 114 kWh/m²/vit, AMF në Beguncë 122 kWh/m²/vit, QMF në Smirë 108 kWh/m²/vit, AMF në Skifteraj 119 kWh/m²/vit, QMF në Pozharan 239 kWh/m²/vit). Konsumi është më i lartë sepse te këto ndërtesa ofrohen shërbime gjatë tërë orarit të punës, ndërsa ndërtesat tjera nuk ofrojnë shërbime gjatë gjithë ditës, por vetëm gjatë ditëve të caktuara dhe me orar të caktuar. Konsumi i ulët i energjisë në këtë ndërtesa nuk i bën më shumë eficiente se ato që konsumojnë energji më shumë. Për të fituar të dhëna më të sakta për performancën energjetike të ndërtesave rekomandohet që të bëhet Auditimi i energjisë.

Nga këtu mund të konstatohet se objektet e sektorit të shëndetësisë në masë të madhe konsumojnë drurin dhe kjo kryesisht gjatë sezonës dimërore që i dedikohet ngrohjes së


hapësirave të objekteve të sektorit të shëndetësisë.

Në tabelën në vijim është paraqitur këto objekte dhe për secilën janë paraqitur të dhënat karakteristike për konsumin e energjisë.

Tabela 7. Ndërtesat e Sektorit të Shëndetësisë

| Nr. | EMËRTIMI I NDËRTESES | ADRESA / VENDI | VITI I NDERTIMIT | SIPËRFA QE m ² | SHPENZIMI VJETOR | | SHPENZIMI MESATAR VJETOR | | |
|---------------|----------------------|--------------------|------------------|---------------------------|------------------------------|------------------------------|--------------------------|-----------------------|--|
| | | | | | Energji Elektrike (kWh) 2013 | Energji Elektrike (kWh) 2014 | ENERGJI ELEKTRIKE (kWh) | ENERGJI TERMIKE (kWh) | Konsumi specifik kWh/m ² /vit |
| 1 | QKMF | Viti | 1977 | 2380 | 15,076 | 14,433 | 29,509 | 242,834 | 114 |
| 2 | AMF | Begunce | 2000 | 121.5 | 560 | 770 | 1,330 | 13,491 | 122 |
| 3 | QMF | Smire | 1982 | 138 | 676 | 736 | 1,412 | 13,491 | 108 |
| 4 | QMF | Sllatine e Eperme | 1972 | 161 | 885 | 786 | 1,672 | 13,491 | 94 |
| 5 | AMF | Zhiti | 1984 | 178 | 450 | 470 | 920 | 13,491 | 81 |
| 6 | AMF | Skifteraj | 1979 | 124 | 710 | 575 | 1,285 | 13,491 | 119 |
| 7 | QMF | Pozharan | 1972 | 364 | 2,902 | 3,370 | 6,272 | 80,945 | 239 |
| 8 | AMF | Stubell e Eperme | 1987 | 311 | 914 | 947 | 1,861 | 3,373 | 17 |
| 9 | QMF | Sadovine e Jerlive | 2000 | 121 | 974 | 951 | 1,925 | 6,745 | 71 |
| 10 | AMF | Terpeze | 2004 | 250 | 450 | 1,233 | 1,683 | 6,745 | 34 |
| 11 | AMF | Remnik | 1984 | 250 | 490 | 920 | 1,410 | 6,745 | 33 |
| 12 | AMF | Goshice | 1979 | 150 | 987 | 540 | 1,527 | 6,745 | 55 |
| TOTALI | | | | 4552 | 25,073 | 25,732 | 50,806 | 421,588 | 742 |

Figura 7. Konsumi i energjisë për nënsektorin e Shendetësisë shprehur si konsum specifik (kWh/m²/vit)



5.5. NDËRTHESAT E SEKTORIT KULTURË DHE SPORT

Në komunën e Vitisë janë identifikuar 3 objekte të sektorit kulturë dhe sport. Në tabelën e mëposhtme janë renditur objektet e sektorit të kulturës dhe sportit për të cilat janë grumbulluar të dhënat që paraqesin: Emertimi i ndërtesës, Adresën, Sipërfaqen, Burimin e energjisë elektrike - kWh), Shpenzimin e energjisë (për vitet 2012, 2013, 2014), Shpenzimi vjetor mesatar kWh. Nga vlerësimet e bëra shihet se këto objekte të këtij sektori konsumojnë vetëm energji elektrike.

Konsumi total i energjisë në stokun e ndërtesave të kulturës dhe sportit në Komunën e Vitisë është 9 toe dhe i gjithë konsumi i energjisë është energji elektrike. Totali i sipërfaqeve të objekteve të kulturës dhe sportit në këtë komunë është 6837 m².

Në bazë të llogaritjeve konsumi specifik mesatar për tre vitet për objektet e kulturës dhe sportit është **17 kWh/m²/vit**.

Mund të konstatohet se është një konsum i ulët në krahasim me standardet e përcaktuara evropiane, por mund të thuhet se këto objekte të kulturës dhe sportit nuk shfrytëzohen në masë të madhe e posaqërisht gjatë dimrit kur kërkesa për energji termike është e madhe. Duke marrë parasysh këto karakteristika, atëherë mund të përfundojmë se ky konsum specifik kaq i


ulët nuk mund të kuptohet se në këto objekte janë implementuar masat e eficiencës së energjisë apo se kemi të bëjmë me objekte të cilat shfrytëzojnë energjinë në mënyrë të duhur, por kemi shfrytëzim të pakët të këtyre objekteve. Nga vlerësimet e bëra shihet se kemi konsum të lartë në ndërtesat e komunës së Vitisë që ofrojnë shërbime gjatë gjithë javës dhe me orar të plotë të punës, ndërsa më të ulët në ndërtesa tjera. Konsumi i ulët i energjisë në këtë ndërtesa nuk i bën më shumë eficiente se ato që konsumojnë energji më shumë. Për të fituar të dhëna më të sakta për performancën energjetike të ndërtesave rekomandohet që të bëhet Auditimi i energjisë.

Në tabelën në vijim janë paraqitur këto objekte dhe për secilën janë paraqitur të dhënat karakteristike për konsumin e energjisë.

Tabela 8. Ndërtesat e Sektorit Kulturë dhe Sport

| Nr. | EMËRTIMI I NDËRTESESË | ADRESA / VENDI | SIPËRFAQE m2 | SHPENZIMI VJETOR | | SHPENZIMI MESATAR VJETOR | | |
|---------------|--|----------------|--------------|------------------------------|------------------------------|--------------------------|-----------------------|-----------------------------|
| | | | | Energji Elektrike (kWh) 2013 | Energji Elektrike (kWh) 2014 | ENERGJI ELEKTRIKE (kWh) | ENERGJI TERMIKE (kWh) | Konsumi specifik kWh/m2/vit |
| 1 | Shtëpia e Kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani" | Viti | 6147 | 15,076 | 14,433 | 29,509 | 242,834 | 15.36 |
| 2 | Biblioteka | Pozhoran | 450 | 560 | 770 | 1,330 | 13,491 | 12.53 |
| 3 | Qendra për Informim dhe Turizem | Pozhoran | 240 | 676 | 736 | 1,412 | 13,491 | 19.43 |
| TOTALI | | | 6837 | 86634 | 80360 | 137793 | | 47.32 |

Figura 8. Konsumi i energjisë për nënsektorin e Shëndetësisë shprehur si konsum specifik (kWh/m²/vit)



5.6. NDËRTESTAT E SEKTORIT REZIDENCIAL

Sa i përket shtëpive individuale nuk ekziston legjislacion në fuqi i cili rregullon konsumin e energjisë në ato hapësira dhe as komuna nuk ka juridiksion mbi këtë pikë. Në përgjithësi këto ndërtesa karakterizohen me një mbështjellës të pazoluar në një përqindje me të madhe ndërsa ndërtimin e ri ka karakteristika me të mira termike. Mënyra kryesore e ngrohjes është me stufa individuale që djegin dru zjarri, thëngjill, por edhe ngrohje qendrore shtëpiake me naftë, rryme e së fundi edhe me pelet.

Sipas regjistrimit të vitit 2011 ka rezultuar se pjesa më e madhe e popullsisë jeton në hapsirën rurale (57.3%) ndërsa 42.6% e popullsisë jeton në hapsirën urbane. Nga anketa e AUK-ut për sektorin rezidencial në nivel vendi 85% e shtëpive ngrohen me dru, ndërsa 9% e tyre për ngrohje e përdorin energjinë elektrike. Shpenzimi mesatar vjetor për shtëpi është 10m³ dru. Të dhënat janë alarmante edhe për hapsirat brenda shtëpive në të cilat përdorin ngrohjen, mëse 41% e shtëpive ngrohjin vetëm një dhomë, 31% e tyre përdorin ngrohje në dy dhoma. Edhe pse fatura mujore për energji elektrike është më e ulëta në rajon, ajo është më e lartë krahasuar me të ardhurat e popullsisë, dhe përbën 10% deri 31% e të ardhurave totale. Pra energjia elektrike paraqet një barrë shumë të madhe për familjet dhe nga këto të dhëna alarmante rekomandohet që sa më parë të fillohet me zbatimin e masave për eficiency të energjisë edhe në sektorin rezidencial. Poashtu sipas raportit vjetor të ZRRE për vitin 2014 konsumi i sektorit rezidencial (amvisëri) i energjisë elektrike edhe më tutje është dominues ndaj konsumit të përgjithshëm të faturuar dhe përbën 56.5%.

Ndërtesat shumë katëshe gjithashtu nuk janë në përgjegjësinë e komunës për të menaxhuar mirëmbajtjen e tyre dhe kjo është e rregulluar me ligjin mbi "Ligji për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi". Këto ndërtesa karakterizohen me mbështjellës të pa izoluar në aspektin termik. Konsumi i energjisë është kryesisht energji

elektrike për ngrohje, por edhe stufa individuale me dru, si dhe një numër i madh i ndërtesave të reja posedon ngrohje qendrore individuale për këto objekte.

Për me shume informacione për ndërtesat e sektorit rezidencial shih ne kapitullin 4, respektivisht titullin 4.2.

5.7. NDRIÇIMI PUBLIK

Rrjeti i ndriçimit publik në qytetin e Vitisë është kryesisht i ndërtuar me një strukturë të degëzuar dhe të organizuar nëpër pika matëse në trafostacione dhe në ormana shpërndarës 0.4 kV. Rrjeti elektrik i ndriçimit publik është i lidhur në rrjetin distributiv ajror dhe kabllor nëntokësor të KEDS-it.

I tërë sistemi i ndriçimit në territorin e komunës së Vitisë është përgjegjësi e autoriteteve lokale komunale.

5.7.1. STRUKTURA E PERGJITHSHME E NDRIÇIMIT PUBLIK

Sipas të dhënave të mbledhura, tërësia e gjatësisë rrugore me ndriçim publik është 24.215 km'. Kapaciteti total i instaluar është prej 57.75 kW. Shtyllat e ndriçimit publik në qytetin e Vitisë janë shtylla metalike të zingëtuara, ndërsa në vendbanimet jashtë qytetit në fshatra shtyllat e ndriçimit publik kryesisht janë te materialit të drurit dhe pjesa më e madhe e këtyre shtyllave i përkasin KEDS-it. Ormanat shpërndarës 0.4 kV dhe janë të përforcuar në bazament të betonit, janë të mbyllur me çelës, ku edhe janë të instaluar edhe pikat matëse të energjisë elektrike. Furnizimi është bërë me kabllor nëntokësor ose ajror.

Llambat e instaluar janë të tipit ekonomik, Na dhe HPS me fuqi: 55W, 65W, 80W, 150W etj. dhe të vendosura në shtylla me lartësi 3m', 4m', 7m', 9m' dhe 12 m' me gjithsejt 1061 poça ndriqes. Shpenzimet mesatare vjetore të Komunës së Vitisë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik janë 9,550.00Euro.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rrugët e qytetit të Vitisë dhe rrugët e disa fshatrave të kësaj komuna të cilat kane ndriçim publik. Janë gjithsejt 27 lokacione që është i shtrirë rrjeti i ndriçimit duke përfshirë rrugë dhe sheshe të qytetit të Vitisë, fshatra dhe hapësira publike me rëndësi për komunitetin e komunës së Vitisë. Po ashtu në këtë tabelë është paraqitur shpenzimi i energjisë elektrike (kWh) për vitet 2012, 2013 dhe 2014, shpenzimi mesatar i energjisë elektrike (kWh) në vit është: 130,855.60 kWh.

Bazuar në të dhënat e mësipërme rekomandohet që në të ardhmen Komuna e Vitisë sa i përket ndriçimit publik të orientohet në instalimin e ndriçimit effiçient LED, pasi që te ky lloj i ndriçimit arrihet kursimi 60% i energjisë elektrike të shpenzuar. Prandaj rekomandohet të bëhet behet zëvendësimi i poqave ndriqes ekzistues me ata poqa ndriqes LED.

Tabela 9. Ndriçimi Publik

PLANI KOMUNAL PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË 2016 – 2020

| EMËRTIMI I NDËRTESES | ADRESA / VENDI | SHPENZIMI VJETOR | | | | | |
|---|-------------------|------------------|------------------|---------|------------------|---------|---------------|
| | | 2012 | Energji (kWh) | 2013 | Energji (kWh) | 2014 | Energji (kWh) |
| Ndriçimi Publik Viti | Viti | 100.4 | 994.5 | 375.3 | 3715.3 | 763.5 | 7559.0 |
| Ndriçimi Publik qendër | Viti | 1451.7 | 14373.6 | 924.3 | 9151.5 | 1070.4 | 10598.0 |
| Ndriçimi Publik qendër | Viti | 399.7 | 3957.5 | 448.7 | 4442.7 | 638.3 | 6319.5 |
| Ndriçimi Publik Viti | Viti | 339.0 | 3356.6 | 18.5 | 182.7 | 209.2 | 2070.9 |
| Ndriçimi rrugor te pasqyra | Viti | 331.0 | 3276.9 | | 0.0 | | 0.0 |
| Ndriçimi rrugor te kulla | Viti | 2611.1 | 25852.9 | | 0.0 | 48.9 | 483.7 |
| Ndriçimi I lapidarit Pozhoran | Pozhoran | 332.9 | 3295.7 | 3.7 | 36.5 | 17.6 | 174.0 |
| N. Rr.-te çerdhja | Viti | 66.1 | 654.5 | | 0.0 | | 0.0 |
| Lapidari Smirë | Smire | 204.1 | 2020.6 | 113.2 | 1120.5 | 138.1 | 1367.0 |
| Ndriçimi Publik-Pozhoran- Viti | Pozhoran | 141.71 | 1403.1 | 133 | 1316.8 | 293.68 | 2907.7 |
| Seksioni pyjor | Viti | 325.3 | 3220.8 | 251.87 | 2493.8 | 241.46 | 2390.7 |
| Ndriçimi publik Dëshmoret e Kombit-Viti | Viti | 551.69 | 5462.3 | 44.38 | 439.4 | 48.85 | 483.7 |
| Ndriçimi publik-stacioni i autobusëve | Viti | 553.44 | 5479.6 | 40.8 | 404.0 | 165.74 | 1641.0 |
| Ndriçimi publik-Gjylekare | Gjylekare | 249.81 | 2473.4 | 45.08 | 446.3 | 59.23 | 586.4 |
| Ndriçimi publik Pozharan-Viti | | 302.37 | 2993.8 | 20.69 | 204.9 | 179.74 | 1779.6 |
| Ndriçimi i lapidarit, „Gursel e B.Syl” Sodovine e Jerlive | Sod.jerlive | 108.02 | 1069.5 | 197.37 | 1954.2 | 282.64 | 2798.4 |
| Ndriçimi publik-Tiranës-Viti | | 1122.11 | 11110.0 | 684.18 | 6774.1 | 773.79 | 7661.3 |
| Ndriçimi publik- Shtëpia e Kulturës –Qendër – Viti | Viti | 767.32 | 7597.2 | 227.2 | 2249.5 | 382.33 | 3785.4 |
| Lapidari I Tre dëshmorëve | Germove | 162.38 | 1607.7 | 153.34 | 1518.2 | 247.13 | 2446.8 |
| Ndriçimi publik Drobesh | Drobesh | | | 730.08 | 7228.5 | 1486.67 | 14719.5 |
| Ndriçimi publik Kabash | Kabash | | | 86.75 | 858.9 | 468.39 | 4637.5 |
| Ndriçimi publik Zhiti | Zhiti | | | 734.9 | 7276.2 | 627.88 | 6216.6 |
| Ndriçimi publik Binq | Binc | | | 1767.21 | 17497.1 | 1648.64 | 16323.2 |
| Ndriçimi publik Stubell e e perme | St.ep | | | 1551.74 | 15363.8 | 826.32 | 8181.4 |
| Ndriçimi I lapidarit te renve 1912-Smire | Smirë | | | 147.12 | 1456.6 | 45.16 | 447.1 |
| Planifikimi hapësinor kuvendi komunal Idriz Seferi | Viti | | | 761.95 | 7544.1 | 1919 | 19000.0 |
| Ndriçimi publik Pozharan | Pozharan | | | 169.25 | 1675.7 | 154.58 | 1530.5 |
| Komiteti Komunal | Viti | | | 4048.99 | 40089.0 | 2123.62 | 21025.9 |
| Ndriçimi publik Lapidari- Gjylekarë | Gjylekarë | | | 84.37 | 835.3 | 59.23 | 586.4 |

| | | | | | | | |
|--|-----------|-----------------------|-------------------|-----------------------|-------------------|----------------------|-------------------|
| Ndriçimi publik stadiumit te varrezat | Viti | | | | | 485.73 | 4809.2 |
| Ndriçimi I lapidarit Terpez | Terpezë | | | | | 326.41 | 3231.8 |
| Ndriçimi publik parku Stubëll e Epërme | St.Epërme | | | 33.21 | 328.8 | | |
| TOTAL | | 10,120.20 Euro/Vit | 100.20 MWh/Vit | 13,797.10 Euro/Vit | 136.61 MWh/Vit | 15,732.0 Euro/Vit | 155.76 MWh/Vit |

Tabela 9.1. Ndriçimi Publik – konsumi total në vite

| Viti | 2012 | 2013 | 2014 |
|-----------------------------|-----------|-----------|-----------|
| Konsumi i energjisë MWh/Vit | 100.20 | 136.61 | 155.80 |
| Shpenzimi Euro/Vit | 10,120.21 | 13,797.10 | 15,732.00 |

5.8. TRANSPORTI

Kryesisht sektori i transportit është një nga konsumatorët më të mëdhenj të energjisë. Për shembull sektori i transportit në Bashkimit Evropian është konsumatori i dytë më madh i konsumit të energjisë, menjëherë pas sektorit të amvisërisë dhe sektorit të shërbimeve. Në vitin 2010, sektori i transportit ka konsumuar ne masën pre 31,7% të konsumit total final të energjisë.

Parashikohet që konsumi i energjisë dhe emitimi në sektorin rezidencial dhe transportit do të rritët me rritjen e pronësisë se veturave në të ardhmen. Kështu që do të jetë shumë e nevojshme intensifikimi i transportit publik, për të përmirësuar cilësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe për të reduktuar fluksin e madh të bllokimeve të trafikut në qendër të qytetit.

Bazuar në një studim të bërë nga Universiteti Amerikan në Kosovë i titulluar “Konsumi i Energjisë në Amvisëri në Kosovë” rreth 36 % e shtëpive Kosovare nuk kanë në pronësi një veturë (56 % e automjeteve përdorin dizelin si karburant) dhe 42% e pronarëve të veturave disel do të konsumojnë 25-50 Litra karburant/muaj. 20% e pronarëve të veturave konsumojnë më pak se 25 Litra/muaj dhe 20% tjerë konsumojnë rreth 51-75 Litra/muaj. Norma të ngjashme janë regjistruar edhe të konsumi nga makinat me benzinë.

Objektivat kryesore për zhvillimin e infrastrukturës rrugore, përfshijnë:

- Përmirësimi dhe Zhvillimi i trafikut publik për të reduktuar bllokimet në trafik si dhe për të zvogëluar ndotjen e ambientit;
- Krijimi i një transporti publik të përshtatshëm, të sigurt dhe atraktiv për udhëtarët

(çmimet,shërbimet, etj.);

- Për të zhvilluar një sistem të avancuar,efiçient dhe të shfrytëzueshëm të ndriçimit publik.
- Promovimi dhe mbështetja e ecjes dhe çiklizmit
- Prezantimi inovativ i emetimit të CO2 për një transport publik”friendly”
- Rritja e numrit të përdorimit të biçikletave, duke përmirësuar infrastrukturën, ofrimi i biçikletave;
- Mjetë për bartjen ne transport, ndërtimi i shtegut për biçikleta;
- Përmirësimi i trotuareve për këmbësor;
- Promovimi i përdorimit të burimeve alternative të lendeve djegëse siç janë biokarburantët, GLN, dhe LPG apo energji elektrike;
- Fushata vetëdijesuese per vozitësit marrë ne konsideratë qeshtjet ambientit duke inkurajuar blerjen e veturave të reja;
- Fushata vjetore për të analizuar nivelin e konsumit të energjisë dhe emitimet e gazrave serrë nga ngasja e automjeteve të komunës, si dhe trajnimin eko-drive për punonjësit Komunal;
- Krijimi i më shumë linjave për autobus dhe shtigjeve për çiklizëm.

6. POTENCIALI PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Plani i Veprimit i Kosovës për Efiçencën e Energjisë ka parashikuar një rritje vjetore prej 1.97%-2.30% në numrin e ndërtesave të banimit në Kosovë deri në vitin 2020. Nuk parashihet ndonjë rënje në sipërfaqen mesatare të banimit (m²/familje). Nga kjo parashihet një rritje e kërkesës për energji në nivel kombëtar me një normë vjetore prej rreth 4%.




Fig. 9. Parashikimi i kërkesës për energji në Kosovë (ktoe) (2005-2018)

Për ti bërë ballë kësaj rritje është paraparë një potencial i konsiderueshëm që implementimi i masave EE bartë në reduktimin e nevojave për energji. Veçanërisht stoku i ndërtesave ofron mundësi të mëdha për kursim të energjisë. Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e energjisë për një ndërtesë konsumohet për qëllime të ngrohjes së hapësirave dhe ujit sanitar (rreth 219 kWh/m²), potenciali më i madh për kursim lidhet me përmirësimin e izolimit termik

të ndërtesave, reduktimin e humbjeve të energjisë për ngrohje dhe përdorimi i bojlerëve eficientë. Ne bazë të të dhënave mbi gjendjen reale të konsumit në stokun e ndërtesave komunale, ndriçimit publik dhe transportit, për arritjen e kursimit energjetik në komunën e Vitisë janë konsideruar dy kategori të masave për t'u ndërmarrur:

1. Masat legjislative dhe organizative

2. Masat teknike

6.1. MASAT LEGJISLATIVE DHE ORGANIZATIVE

Masat legjislative dhe organizative të cilat janë të zbatueshme brenda kompetencave të Komunës janë:

- Përfshirja e EE në kuadër të prioriteteve të Komunës së Vitisë
- Themelimi i ZKEE
- Modifikimi i kuadrit ligjor dhe politikave tatimore në nivel komunal me qëllim inkurajimin e investimeve në EE
- Rritja e përgatitjes profesionale dhe burimeve për EE në stafin komunal nëpërmjet programeve të ndryshme të trajnimit
- Inkuadrimi i kërkesave EE si kritere në procesin e vlerësimit të projekteve dhe Vizita studimore në vendet me praktika të mira
- Aplikimi i Kodit të ri të Energjisë në Ndërtim (Udhëzimi Administrativ për rregullimin e humbjeve termike në ndërtesa) për ndërtesat e reja
- Kryerja e auditimeve të energjisë në ndërtesat komunale
- Studimi dhe mbledhja e të dhënave mbi konsumin e energjisë në sektorin rezidencial të komunës
- Ndërrmarja e fushatave vetëdijësuese dhe organizimi i debateve qytetare dhe këndeve informative
- Krijimi i një forumi të energjisë në të cilin NVM-të do të siguronin informacione në lidhje me EE dhe do të mund ti ndanin eksperiencat e tyre.
- Hartimi i Planit komunal të Mobilitetit për transportin me objektivë optimizmin dhe uljen e intensitetit të trafikut si dhe shfrytëzimin e mjeteve eficientë të transportit
- Hartimi dhe mbështetja e një plani për Monitorim dhe Verifikim të implementimit të masave EE
- Zbatimi i auditimeve të energjisë në ndërtesa. Vetëm pas zbatimit të auditimeve të energjisë mund të bëhet aplikimi i masave të EE për secilin objekt/ndërtesë me konsum të lartë energjetik.

6.2. MASAT TEKNIKE (RENOVIMET NË NDËRTE SAT DHE NDRIÇIM PUBLIK)

1. Masat që kanë për qëllim reduktimin e kërkesave për konsum energjetik
2. Masat për përmirësimin e metodave të gjenerimit të energjisë

Tabela 10. Masat teknike për reduktimin e konsumit dhe përmirësimin e teknikave të gjenerimit të energjisë

| | Energji Elektrike | Energji për ngrohje |
|--|--|---|
| Reduktimi i konsumit | Ndërrimi i pajisjeve ekzistuese joefiçientë me pajisje eficientë, Përmirësimi dhe zgjerimi i ndriqimit me sistem solar | Shfrytëzimi i dritareve me xham të dyfishtë dhe trefishtë |
| | Shfrytëzimi i trupave ndriçues eficient | Izolimi termik i mureve dhe pullazit |
| | Aplikimi i teknikave racionale të konsumit | Izolimi termik i gypave për shpërndarjen e ujit të ngrohtë |
| Përmirësimi i teknikave të gjenerimit të energjisë | Prodhimi i energjisë nga BRE | Përdorimi i paneleve solare për ngrohjen e ujit |
| | | Prodhimi i energjisë termike nga burimet alternative si gjeotërmia |
| | | Prodhimi i energjisë me teknologji më eficientë (kalldajave kondenzuese, pompave për ngrohje) |

Në bazë të studimeve dhe auditimeve energjetike të ndryshme të kryera në Kosovë dhe në bazë të rekomandimeve të BE dhe rekomandimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ⁴ nga masat EE si më të favorshme sa i përket raportit kosto/kursim janë:

1. Izolimi termik i mureve të jashtme
2. Izolimi i pullazit
3. Zëvendësimi i dritareve me ato me xham të dyfishtë/trefishtë
4. Zëvendësimi i sistemeve të furnizimit me ngrohje
5. Zëvendësimi i ngrohësve të ujit sanitar
6. Shfrytëzimi i paneleve solare për ngrohjen e ujit sanitar
7. Aplikimi i ndriqimit eficient
8. Aplikimi i pajisjeve shtëpiake eficiente

Kostoja dhe kthimi i investimit për këto masa, për ndërtesat në komunën e Vitisë mund të llogariten saktësisht vetëm pasi të jenë kryer auditimet energjetike në ndërtesat e sektorëve të

⁴ Energy Efficiency in the Contracting Parties of the Energy Community, ECS/ENSI, February 2012

ndryshëm. Megjithatë për të pasur një pasqyrë të përgjithshme në lidhje me vlerat e investimit për secilën masë EE për ndërtesa të sektorëve të ndryshëm, më poshtë është dhënë tabela për vlerat njësi të investimit për Kosovë nga raporti i Institutit të Bankës Botërore⁵.

Tabela 11. Vlerat e investimit për masa EE

| Masa EE | Investimi [€/njësi] | Ndërtesat rezidenciale | Ndërtesat komunale |
|------------------------------------|---------------------|------------------------|--------------------|
| Izolimi termik i mureve të jashtme | Euro/m ² | 20 | 18 |
| Izolimi i pullazit | Euro/m ² | 35 | 32 |
| Dritare EE | Euro/m ² | 100 | 90 |
| Sistem EE i furnizimit me ngrohje | Euro/m ² | 35 | 32 |
| Ngrohës EE i ujit sanitar | Euro/njësi | 200 | 2000 |
| Sistem solar i ngrohjes së ujit | Euro/njësi | 500 | 500 |
| Poça efiçient | Euro/njësi | 5 | 5 |
| Pajisje shtëpiake EE | Euro/njësi | 380 | 400 |

Të dhënat e mësipërme janë shfrytëzuar për llogaritjen e vlerave të nevojshme të investimit për ndërtesa të sektorëve të ndryshëm. Këto të dhëna janë vetëm indikative, dhe vlerësimi i saktë i investimit dhe kursimit korrespondues të energjisë mund të bëhet vetëm pas kryerjes së auditimeve të plota të energjisë për çdo ndërtesë.

6.2.1. POTENCIALI PËR KURSIM NË SEKTORIN E NDËRTESAVE PUBLIKE

Konsumi në sektorin e ndërtesave publike në komunën e Vitisë karakterizohet me një konsum specifik vjetor prej 147.67 kWh/m², pra është mjaft i lartë. Kjo do të thotë se implementimi i masave EE jo vetëm që do të rezultojë në kursim të energjisë por do të ngritë edhe nivelin e komfortit në to.

Ndërsa duke marrë parasysh se ndërtesat operojnë nën standardet normale ky kursim do të ishte më i lartë por për këtë duhet aplikuar auditimet energjetike për secilën ndërtesë veç e veç.

⁵ National Building Energy Efficiency Study for Kosovo, Eptisa-Regional Office for SEE, February 2013

Tabela 11.1. Kursimi potencial i energjisë dhe investimet e nevojshme për sektorin e ndërtesave publike dhe ndriçimit publik

| Sektoret qe Administrohen nga KK Viti | Sipërfaqja e ngrohur [m ²] | Përqindja e sipërfaqes në të cilën do të implementohen masat EE [%] | Investimi [euro/m ²] | Kursimi [MWh/vit] | Investimi [euro] |
|---------------------------------------|--|---|----------------------------------|-------------------|---------------------|
| Administratë | 9,725 | 70 | 43 | 985.124 | 292,722.50 |
| Arsim | 41,622 | 55 | 43 | 3,312.751 | 984,360.30 |
| Shëndetësi | 4,552 | 70 | 65 | 597.450 | 207,116.00 |
| Kulturë/sport | - | - | - | - | - |
| Ndriçimi publik | - | 90 | - | 581.035 | 128,925.00 |
| Totali | 55,899 | | | 5,476.36 | 1,613,123.80 |

6.2.2. POTENCIALI PËR KURSIM NGA TRANSPORTI

Kursimi ne transport do të mund të arrihet me rregullimin më eficient të trafikut masiv komunal. Komuna duhet të zbatoj Planin e Mobilitetit të komunës me anë të të cilit do të rregulloheshin Linjat e trafikut urban, parkingjet etj.

6.3. PËRFITIMET SHITESË

Në disa raste, përfitimet shtesë mund të jenë më të “vlershme” për përdoruesit e ndërtesave se sa për kursimet e energjisë dhe ujit. Në vijim janë konsideruar përfitimet shtesë:

Përmirësimi i Cilësisë dhe Qëndrueshmëria e Shërbimeve Komunale. Cilësia e shërbimeve komunale mund të rritët duke ofruar shërbime të qëndrueshme duke siguruar ndriçim më të mirë në rrugë.

Përmirësimi i Klimës së Brendshme në Ndërtesa. Pasi që PKEE të implementohet, klima e brendshme e ndërtesave/institucioneve do të jetë më shumë në përputhje me (sipas) normat dhe kërkesat e Kodit të Energjisë nëpër Ndërtesa. Implementimi i masave të efiçencës së energjisë do të sjell temperatura komfortë dhe të qëndrueshme nëpër dhoma. Dritaret me efiçencë të energjisë do të sigurojnë përfitimin e shtuar të bllokimit të zhurmës dhe pluhurit, dhe mund të hapen dhe mbyllen më lehtë. Një përfitim tjetër është reduktimi i që mund të merren duke jetuar në ndërtesa, duke përmirësuar efektivitetin e përdoruesve të ndërtesës.

Përmirësimi i Kushteve të Ndërtesës, Sistemeve, dhe Pajisjeve. Sistemet dhe pajisjet e përmirësuara do të sjellin një cilësi të përmirësuar të operimit dhe kontrollit të ndërtesave.

Zëvendësimi i pajisjeve të vjetruara me pjesë të reja siguron mundësi më të mira për zbulimin e defekteve, duke reduktuar kështu rastet e emergjencave dhe duke e bërë më të lehtë zgjidhjen e tyre. Stafi operues dhe mirëmbajtës është më i motivuar kur punojnë me pajisje të reja dhe kur ka mjetë që e mundësojnë kontrollin e tyre. Planifikimi i mirëmbajtjes do të reduktojë mundësinë e aksidenteve.

Vetëdijesimi i Eficiencës së Energjisë në Vendim-marrësit Komunal dhe Publikut. Kursimet e energjisë, reduktimet e kostos, përmirësimet e shërbimeve, përfitimet mjedisore janë faktorët që ndikojnë në ngritjen e vetëdijesimit dhe zotimin e udhëheqjes komunale. Projektet e suksesshme janë modelet dhe shembujt e mirë të eficiencës së energjisë dhe bëjnë presion tek banorët komunal, të cilët do të kuptojnë se Komuna po bën një punë të mirë në çështjet mjedisore dhe me kosto të ulëta. Informimi mbi Eficiencën e Energjisë përmes medieve është një faktor i rëndësishëm që ka një ndikim pozitiv në ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve. Një Plan i suksesshëm Komunal i Eficiencës së Energjisë është një shembull i mirë për t'u shfrytëzuar në zgjedhjet e ardhshme, si dhe në shpërndarjen e fondeve.

Përfitimet Mjedisore, Reduktimi i Emetimeve. Përfitimet mjedisore përfshijnë reduktimin e emetimeve në burimet primare të energjisë, si dhe lokale. Plani dhe gazrave të shiut acid.

7. PLANI I VEPRIMIT

Në përputhje me rezultatet e analizës së energjisë, do të jepet një pasqyrë e detajuar e masave optimale për të rritur eficiencën e energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në ndërtesat në pronësi të komunës e ndarë në dy kategori themelore:

- masat dhe aktivitetet promovuese, informative dhe arsimore-dmth. Masat e buta;
- masat e eficiencës së energjisë dhe të burimeve të ripërtërishme të energjisë në ndërtesa.

Është e rëndësishme të theksohet se kategoria e parë e masave do të zbatohet vetëm për ndërtesat në pronësi të komunës, por do të përfshijë një plan të detajuar për ngritjen e vetëdijes dhe njohurive të banorëve të komunës në parimet e eficiencës të energjisë dhe opsionet e kursimit të energjisë në të gjitha aspektet e jetës dhe punës. Kategoria e dytë e masave do të përfshihen për të gjitha ndërtesat ku auditimi i energjisë parasheh një gjë të tilla.

7.1 MASAT ORGANIZATIVE

A. Themelimi i një Ekipi Komunal të Eficiencës së Energjisë

Komuna e Vitisë duhet të krijoj/themeloj një Ekip të Eficiencës së Energjisë që do të përbëhet nga stafi teknik Komunal. Ky ekip do të jetë përgjegjës për:

Menaxhimin dhe Implementimin e Planit Komunal të Eficiencës së Energjisë.

Mbledhja e të dhënave të konsumit të energjisë, ujit, karburanteve, gazit, dhe dru zjarrit nga të gjitha ndërtesat/objektet/institucionet komunale.

Futjen e të dhënave të mbledhura në Bazën e të Dhënave komunale të Energjisë.

Analizimin e të shinave dhe përcaktimin se cilat ndërtesa kanë nevojë për intervenim dhe/apo renovim. Udhëheqësi i ekipit është përgjegjës për të marrur vendimet e nevojshme për implementimin e Planit Komunal të Efiçencës së Energjisë.

B. Themelimi i Bazës së të Dhënave të Energjisë

Për të krijuar Bazën e të Dhënave komunale të Energjisë, duhet të përcjellën procedurat e përshkruara më poshtë:

Një listë e të gjitha ndërtesave/objekteve/institucioneve në pronësi dhe të menaxhuara nga Komuna e Vitisë do të merret nga Zyra e Aseteve Komunale. Do të mblidhen informata në lidhje me zonën, vendndodhjen, vitin e ndërtimit, ndërtimin e ndërtesës, etj.

Do të mblidhen të dhënat tremujore për konsumin e energjisë, ujit, derivateve, gazit, dhe dru zjarrit dhe do të futën në bazën e të dhënave për çdo tremujor dhe çdo vit.

C. Programi i Monitorimit të Energjisë

Ekipi i Efiçencës së Energjisë vendos programin për monitorim dhe vlerësim. Skemat e monitorimit të energjisë, për ndërtesat dhe objektet tjera në komunë, do të krijohen me këtë program. Skema e monitorimit dhe vlerësimit është si në vijim:

Bëhet matja e konsumit të energjisë, ujit, derivateve, gazit, dhe dru zjarrit për çdo ndërtesë/objekt/institucione. Bëhet matja e këtyre komponentëve për çdo muaj duke u bazuar në faturat mujore, të cilat njëherësh edhe kontrollohen. Mirren të dhënat nga institucionet komunale, të cilat i raportojnë Ekipit Komunal të Energjisë. Ekipi i fut të dhënat në Bazën e Të Dhënave të Energjisë çdo tre muaj dhe i vlerëson ato suke përcaktuar ndërtesat me konsumin më të madh të energjisë. Anëtarët e Ekipit EE i propozojnë përmirësimet e mundshme tek menaxheri.

7.2. MASAT EE PËR T’I IMPLEMENTUAR NË NDËRTESEA

Masat më të rëndësishme të përfshira në PKEE janë:

Masat për të përmirësuar Efiçencën e Energjisë në Stokun e Ndërtesave ekzistuese të Sektorit të ndërtimit.

Tërmoizolimi: Tërmoizolimi i stokut të ndërtesave ekzistuese për të përmirësuar standardet termike të ndërtesave në mënyrë që të arrihet standardi për ruajtjen e energjisë. Përmirësimi i stokut të ndërtesave ekzistuese nga këndvështrimi i tërmoizolimit dhe ndërtimi i ndërtesave të reja publike duke u bazuar në kodit e ri energjetik (i cili është duke u përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë) do të bëjë të mundshme kursimin e burimeve të energjisë që përdoren për ngrohje dhe ftohje.

Renovimi i Brendshëm i Sistemeve të Ngruhjes: Për rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese, e cila do të propozohet në të ardhmen, rekomandohen propozimet për sisteme të ngruhjes më efiçientë nga lloji dhe shumica e ndërtesave të izoluar.

Ndriçimi me Eficiencë Energjisë: Plani Komunal i Eficiencës së Energjisë parasheh zëvendësimin e përgjithshëm të të gjitha llambave jo eficiente me llamba me eficiencë të energjisë / ekonomike(LED).

Masat Jo-Teknike (veprimet e promovimit dhe vetëdijesimit).

Ekipi i Komunës së Vitisë do të organizojë fushata të ngritjes së vetëdijes për të promovuar eficiencën e energjisë duke ditur specifikat e secilit grup të targetuar dhe duke përdorur fakte dhe praktika konkrete për motivim.

Tabela 12. Plani i veprimit-aktiviteteve

| | Veprimi / Aktiviteti | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|--|------|------|------|------|------|------|
| 1 | Fillimi i implementimit të PKEE-së dhe përcaktimi i procedurave | — | | | | | |
| 2 | Themelimi dhe mirëmbajtja e Bazës së të Dhënave të Energjisë | — | — | — | — | — | — |
| 3 | Monitorimi i Energjisë, përfshirë raportimi ⁽¹⁾ | — | — | — | — | — | — |
| 4 | Auditimi i Energjisë nëpër Ndërtesa ⁽²⁾ | — | — | | | | |
| 5 | Implementimi i projekteve EE në ndërtesat komunale | — | — | — | — | — | — |
| 6 | Implementimi i projekteve të ndriçimit public | — | | | | | |
| 7 | Implementimi i projekteve ne transport | — | — | | | | |
| 8 | Implementimi i projekteve ne sektorin rezidencial | — | — | — | — | | |
| 9 | Trajnim i vazhdueshëm i Ekipit për EE por edhe inxhinierëve/teknikëve tjerë në komunë, si dhe organizim i vizitave studimore | — | — | — | — | — | — |

⁽¹⁾ *Procesi i monitorimit të energjisë ka filluar në vitin 2009 dhe të vazhdoj deri në 2016. Ky proces do të përfshij të gjitha projektet e implementuara nga Komuna e Vitisë, sipas PKEE-së.*

7.3. KORNIZA KOHORE DHE FINANCIARE PËR ZBATIMIN E MASAVE/AKTIVITETEVE TË IDENTIFIKUARA

Aktivitetet e identifikuar janë paraqitur në këtë kapitull, në formë tabelare, ku për çdo masë janë dhënë parametrat e mëposhtëm:

- Koha e zbatimit;
- Organi përgjegjës për zbatimin;
- Vlerësimi i kostos investive të zbatimit;
- Vlerësimi i kursimit të energjisë;
- burimet e mundshme për të financuar zbatimin;
- një përshkrim të shkurtër të masave dhe metodat e zbatimit.

Tabela 13. Përshkrimi i aktiviteteve në sektorin e informimit/vetëdijësimin të qytetarëve

| | |
|---|---|
| Sektori i informimit public | |
| Emertimi i aktivitetit | Hapja e këndeve informuese për qytetarët mbi EE |
| Përgjegjës për zbatim | Komuna e Vitisë |
| Fillimi/përfundimi i zbatimit (vit) | 2016-2020 |
| Vlerësimi i shpenzimeve total | 25.000.00 Euro |
| Kursimi (% ose kWh, ose Euro) | 0 % |
| Burimi i të ardhurave për financim | Institucionet qendrore Donatoret (IPA fondet, BB) Komuna |
| Përshkrim i shkurtër i aktivitetit | - broshura/fletëpalosje mbi EE - informacione mbi EE - materiale mbi kursimin e energjisë - informacione të ndryshme mbi zbatimin e masave të EE |
| Vërejtje: Përshkrimi i projektit është i detalizuar pas zbatimit të Aditimit të Energjisë | |

Tabela 14. Përshkrimi i aktiviteteve në sektorin e administratës

| | |
|---|---|
| Sektori i Administratës | |
| Emertimi i aktivitetit | Implementimi i masave të EE për Kuvendi Komunal Viti |
| Përgjegjës për zbatim | Komuna e Vitisë |
| Fillimi/përfundimi i zbatimit (vit) | 2016-2018 |
| Vlerësimi i shpenzimeve totale | 292,722.50 Euro |
| Kursimi (% ose kWh, ose Euro) | 35% |
| Burimi i të ardhurave për financim | Institucionet qendrore Donatoret (IPA fondet, BB) Komuna |
| Përshkrim i shkurtër i aktivitetit | Izolimi termik i mureve të jashtme Izolimi termik i kulmit Ndërrimi i dritareve dhe dyerve Renovimi i sistemit elektrik Renovim i sistemit të ngrohjes qendrore |
| Vërejtje: Përshkrimi i projektit është i detalizuar pas zbatimit të Aditimit të Energjisë | |

Tabela 15. Përshkrimi i aktiviteteve në sektorin e arsimit

| | |
|---|---|
| Sektori i Arsimit | |
| Emertimi i aktivitetit | Implementimi i masave të EE për stokun e ndërtesave Arsimore |
| Përgjegjës për zbatim | Komuna e Vitisë |
| Fillimi/përfundimi i zbatimit (vit) | 2016-2020 |
| Vlerësimi i shpenzimeve totale | 984,360.30 Euro |
| Kursimi (% ose kWh, ose Euro) | 35% |
| Burimi i të ardhurave për financim | Institucionet qendrore Donatoret (IPA fondet, BB) Komuna |
| Përshkrim i shkurtër i aktivitetit | Izolimi termik i mureve të jashtme Izolimi termik i kulmit Ndërrimi i dritareve dhe dyerve Renovimi i sistemit elektrik Renovim i sistemit i ngrohjes qendrore Instalimi i paneleve solare |
| Vërejtje: Përshkrimi i projektit është i detalizuar pas zbatimit të Aditimit të Energjisë | |

Tabela 16. Përshkrimi i aktiviteteve në sektorin e shëndetësisë

| | |
|---|---|
| Sektori i Shëndetësisë | |
| Emertimi i aktivitetit | Implementimi i masave të EE për stokun e ndërtesave të shëndetësisë – QKMF |
| Përgjegjës për zbatim | Komuna e Vitisë |
| Fillimi/përfundimi i zbatimit (vit) | 2017-2020 |
| Vlerësimi i shpenzimeve totale | 207,116.00 Euro |
| Kursimi (% ose kWh, ose Euro) | 30% |
| Burimi i të ardhurave për financim | Institucionet qendrore Donatoret (IPA fondet, BB) Komuna |
| Përshkrim i shkurtër i aktivitetit | Izolimi termik i mureve të jashtme Izolimi termik i kulmit Ndërrimi i dritareve dhe dyerve Renovimi i sistemit elektrik Renovim i sistemit i ngrohjes qendrore Instalimi i paneleve solare |
| Vërejtje: Përshkrimi i projektit është i detalizuar pas zbatimit të Aditimit të Energjisë | |

Tabela 17. Përshkrimi i aktiviteteve në sektorin e Ndriqimit publik

| | |
|-------------------------------------|--|
| Sektorin e Ndriqimit publik | |
| Emertimi i aktivitetit | Implementimi i masave të EE për Ndriqim publik |
| Përgjegjës për zbatim | Komuna e Vitisë |
| Fillimi/përfundimi i zbatimit (vit) | 2016 |
| Vlerësimi i shpenzimeve totale | 128,925.00 Euro |
| Kursimi (% ose kWh, ose Euro) | 45% |
| Burimi i të ardhurave për financim | Institucionet qendrore Donatoret (IPA fondet, BB) Komuna |
| Përshkrim i shkurtër i aktivitetit | Zëvendësimi i sistemit ndriqes ekzistues me sistem ndriqes LED me standarte të EE. |
| | |

Tabela 18. Përshkrimi i aktiviteteve në sektorin e Informimit publik

| | |
|-------------------------------------|---|
| Sektorin e Informimit publik | |
| Emertimi i aktivitetit | Implementimi i masave të EE për Informim publik |
| Përgjegjës për zbatim | Komuna e Vitisë |
| Fillimi/përfundimi i zbatimit (vit) | 2017-2019 |
| Vlerësimi i shpenzimeve totale | 100,000.00 Euro |
| Kursimi (% ose kWh, ose Euro) | - |
| Burimi i të ardhurave për financim | Institucionet qendrore Donatoret (IPA fondet, BB) Komuna |
| Përshkrim i shkurtër i aktivitetit | - Fushatë vetëdijësuese për sektorin e Amvisërisë/rezidencial - Fushatë vetëdijësuese për NVM - Fushatë vetëdijësuese për nxënës të shkollave në nivele të ndryshme dhe programe inovative për promovimin e EE. |
| | |

8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Ekipi i Efiçencës së Energjisë do të jetë përgjegjës për përgatitjen e programit për monitorim dhe vlerësim. Skemat e monitorimit të energjisë për ndërtesat dhe objektet tjera të komunës do të krijohen nga ky program. Skema e monitorimit dhe vlerësimit është siç vijon:

Matja e furnizimit të energjisë, derivateve, gazit, dhe dru zjarrit kryhet për çdo ndërtesë/objekt/institucione komunale.

Matja e këtyre komponentëve kryhet për çdo muaj duke u bazuar në faturat mujore, të cilat kontrollohen në të njëjtën kohë.

Mbledhja/marrja e të dhënave nga ndërtesat/institucionet komunale të cilat raportojnë te Ekipi i Efiçencës së Energjisë.

Futja e të dhënave nga Ekipi i Efiçencës së Energjisë në Bazën e të Dhënave të Energjisë çdo tre muajë dhe vlerësimi i tyre duke përcaktuar ndërtesat dhe/apo institucionet me konsumin më të lartë të energjisë.

Anëtarët e Ekipit të Efiçencës së Energjisë propozojnë përmirësimet e mundshme tek menaxheri i ndërtesës.

Anëtarët e ekipit të Efiçencës së Energjisë raportojnë rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të Udhëheqësi i Ekipit të Efiçencës së Energjisë.

Në raportimin dhe vlerësimin e ndërtesave, merren parasysh kritere të ndryshme për të përcaktuar ndërtesat/objektet/institucionet ku duhet të bëhen intervenimet. Konsumi i energjisë së ndërtesave, dendësia e banorëve për m² në një ndërtesë, ndërtesat e vjetra në nevojë për rindërtim të plotë, dhe karakteri i një ndërtese (arsimore, kulturore, shëndetësore, sociale, etj.) janë shembuj të kritereve të marra në konsideratë.

Raportimi kryhet çdo gjashtë muaj, Në fund të çdo viti, do të bëhet vlerësimi i ndërtesave/objekteve/institucioneve ku janë implementuar Masat e Efiçencës së Energjisë dhe raportohet ne Agjencinë e Kosovës për Efiçencës së Energjisë.

Pas marrjes së raporteve nga anëtarët e ekipit, udhëheqësi i ekipit konsultohet me specialistët e fushave të ndryshme në komunë dhe përcakton se në cilat ndërtesa/objekte të intervenohet për të implementuar masat e efiçencës së energjisë.

REFERENCAT

1. Plani i Veprimit i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (2010-2018)-MZHE, 2011
2. Ligji për Efiçencën e Energjisë, MZHE, 2011
3. Strategjia e Energjise e Republikës së Kosovës 2009-2018
3. Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës, MZHE, 2011
4. National Building Energy Efficiency Study for Kosovo, World Bank Institutë, 2013
5. Kosovo Household Energy Consumption- AUK, 2013
6. Energy Efficiency in the Contracting Parties of the Energy Community, ECS/ENSI, February 2012
7. Banesat dhe ndërtesat sipas komunave, regjistrimi i popullsisë 2011, ASK
8. Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë ne sektorin e shërbimeve, MZHE
9. Energy Efficiency, Jenny Palm, Rijeka, Croatia 2012